REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA POGRADEC**
**KËSHILLI**

Nr. 746/12 Prot. Pogradec, më 22. 02. 2022

# VENDIM

**NR. 10 , DATË 18 . 02.2022**

## MIRATIMI I PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË DATËS 20.01.2022 TË KËSHILLIT BASHKIAK POGRADEC

Këshilli I Bashkisë Pogradec në mbledhjen e tij të datës së sotme,pasi lexoi proces-verbalin e zbardhur nga Sekretarja e Këshillit të mbledhjes së datës 20.01.2022, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" neni 53, pika 8 dhe neni 54, gërma k si dhe neni 92 e Rregullores së Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Pogradec miratuar me VKB nr 40, datë 05.03.2020.

**KËSHILLI I BASHKIAK**

**VENDOSI:**

1. Të miratojë proces verbalin e mbledhjes të Këshillit të Bashkisë Pogradec , të datës 20.01.2022 bashkangjitur.
2. Kopja e proces verbalit të miratuar administrohet nga Sekretarja e Këshillit sipas procedurave ligjore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR I KËSHILLIT**

**Sotiraq MANGËRI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA POGRADEC

**Mbledhje e Këshillit Bashkiak** Pogradec më 20.01.2022

ORA : 12:00

JANË PREZENT 18 KËSHILLTARË

PROTOKOLLI I MBLEDHJSES SË KËSHILLIT BASHKIAK POGRADEC DATE 20.01.2022, ME KËTË REND DITE.

RENDI I DITËS

1. **Projekt – vendim:** Miratimi i Rendit të ditës së Mbledhjes, sipas nenit 53, pika 5, ligji 139/2015.
2. **Projekt – vendim:** Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së datës 24.12.2021 të Këshillit Bashkiak Pogradec
3. **Projekt – vendim :** "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6% e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike,për muajin Dhjetor 2021"
4. **Projekt – vendim:** Per miratimin e kritereve të familjeve në nevojë që do të trajtohen me fondin deri në 6% nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike për vitin 2022.
5. **Projekt – vendim:** "Për miratimin e kërkesës së familjes së z.Shaban Hoxhallari që do të vazhdojë proçedurën e privatizimit të banesës shtetërore që ka mbetur paprivatizuar"
6. **Projekt – vendim:** Për miratimin e kalendarit të programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe të buxhetit vjetor 2022 bashkia pogradec
7. **.Projekt – vendim:**_Për lënien në fuqi të Vendimit Nr. 94, datë 18.11.2021 "Për një Ndryshim në Vendimin Nr. 15, datë 01.03.2017, "Për miratimin e orareve dhe stacioneve për linjat rrethqytetëse".
8. **Projekt – vendim: Per** dhënie ndihmë financiare znj.Zhuljeta Pere me qëllim mbulimin e shpenzimeve të shkollimit të vajzës".

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA POGRADEC

**Propozime dhe diskutime**

Z. S. Manperi

Përshëndetje të gjithëve! Fillojmë mbledhjen e radhës. E para mbledhje për vitin 2022. Për shkak të Kovidit ka mungesa, ndaj ftoj sekretaren e Këshillit Bashkiak të bëj apelin për prezencë.

znj. Bojko. Prezent janë 18 këshilltarë

Z. S. Manperi: Me çështjet e trajtuara në rendin e ditës jeni njohur, ndaj ftoj këshilltarët të hedhim në votim rendin e ditës.

HIDHET NE VOTIM RENDI I DITES::

PRO 18

KUNDËR 0

ABSTENIM 0

**Miratohet** (Po) **Jo**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA POGRADEC -

S. Manperi: Miratohet rendi i ditës, me 18 vota pro.

**Mbledhje e Këshillit Bashkiak** Pogradec më ___.___. 2022

1. **Pika nr** 1 : Miratimi i Rendit të ditës së Mbledhjes, sipas nenit 53, pika 5, ligji 139/2015.

Diskutime

Z. S. Mangani

Vazhdojmë me pikën nr. 1, miratimin e Rendit të ditës së Mbledhjes, sipas nenit 53, pika 5, ligji 139/2015. Ftoj këshilltarët të hedhim në votim pikën nr. 1

**U votua**

**Pro** 18

**Kundër** 0

**Abstenim** 0

**Miratohet** (Po) Jo

Miratohet Rendi i ditës së Mbledhjes, sipas nenit 53, pika 5, ligji 139/2015 me 18 vota pro

**Mbledhje e Këshillit Bashkiak** **Pogradec më 20.01.2022**

2. **Pika nr 2** : Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së datës 24.12.2021 të Këshillit Bashkiak Pogradec

Diskutime

Z. S. Napoei !

Pika nr. 2 është miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së datës 24.12.2021 të Këshillit Bashkiak Pogradec Procesverbalin e keni parë dhe firmosue, ndaj ftoj Këshilltarët të hedhim në votim pikën nr. 2 të rendit të ditës.

**U votua**

**Pro** 18

**Kundër** 0

**Abstenim** 0

**Miratohet** (Po) **Jo**

Miratohet pika nr. 2. e rendit të ditës me 18 vota pro.

**Mbledhje e Këshillit Bashkiak** Pogradec më 20.01.2022

3. **Pika nr** 3 : : "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6% e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike,për muajin Dhjetor 2021"

Diskutime

z. S. Mangeri

Pika nr. 3 është për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6 % e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, për muajin Dhjetor 2021.

Përfitues të kësaj skeme janë ata individë të cilët nuk kanë asnjë mundësi për të punuar.

Ftoj përfaqësuesen e ndihmës ekonomike t'na informojë më tepër këtij pike

Znj. Mançellari: Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6% e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike për muajin Dhjetor 2021 janë përfituar 153 familje.

Duke e krahasuar me muajin Dhjetor 2020 kemi një ulje, sepse ose janë larguar jashtë vendit, ose janë punësuar diku.

Z. S. Mangeri: Ftoj këshilltarët të hedhim në votim pikën nr. 3 të rendit të ditës

**U votua**

**Pro** 18

**Kundër** 0

**Abstenim** 0

**Miratohet** (Po) Jo

Miratohet pika nr 3. e rendit të ditës, me 18 vota pro

**Mbledhje e Këshillit Bashkiak** Pogradec më 20 . 01 . 2022

4. **Pika nr 4** : Per miratimin e kritereve të familjeve në nevojë që do të trajtohen me fondin deri në 6% nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike për vitin 2022.

Diskutime

Z. S. Mangari : Vazhdojmë me pikën nr. 4. të rendit të ditës, për miratimin e kritereve të familjeve në nevojë që do të trajtohen nga fondin deri në 6 % nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike për vitin 2022.

Z. S. Hoxhillari : Nuk e shoh të arsyeshme të shtojmë apo të heqim ndonjë kriter, për familjet të cilat do të jenë pjesë e kësaj skeme.

Znj. Mancellari : Nga përfitimi i kësaj ndihme largohen vetëm ato familje të cilat dalin me pikë të pamjaftueshme nga sistemi, kemi nuk përfshihet tek kjo skemë.

Z. A. Guxholli : Familjet të cilat dalin nga sistemi, nuk kanë mundësi që për një farë kohe të aplikojnë përsëri?

Znj. Mancellari : Po, Mund të aplikojnë dhe nëse sistemi i nxjerr me pikë të mjaftueshme, ~~atëherë~~ shpallen fitues.

S. Mangari : Ftoj këshilltarët të hedhim në votim, pikën nr 4,

**U votua** Vjen N. Bordo dhe A. Sala.

**Pro** 20

**Kundër** 0

**Abstenim** 0

**Miratohet** (Po) Jo

Miratohet pika nr 4, e rendit të ditës me 20 vota pro

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA POGRA

**Mbledhje e Këshillit Bashkiak** Pogradec më 20.01.2022

5. **Pika nr** 5 : "Për miratimin e kërkesës së familjes së z.Shaban Hoxhallari që do të vazhdojë proçedurën e privatizimit të banesës shtetërore që ka mbetur paprivatizuar"

Diskutime

Z. S. Manperi: Pika nr 5. e rendit të ditës është për miratimin e kërkesës së familjes së z. Shaban Hoxhallari që do të vazhdojë procedurën e privatizimit të banesës shtetërore që ka mbetur e paprivatizuar.

Kemi përfaqësuesin e Hipotekës për t'na shpjeguar më tepër.

Përfaqësuesi i Hipotekës:

Këto dokumente kanë dalë nga hipoteka, por kanë dalë pa vulë, sep

Me ndryshimin e procedurave, tani duhen të vulosen, por më parë duhet të miratohet nga Këshilli Bashkiak.

Z. G. Hoxhallari: Duke parë se ky problem do të përsëritet, ne po i japim zgjidhje problemit duke e miratuar dhe hipoteka të vazhdojë procedurat.

Z. S. Manperi: Ftoj këshilltarët të hedhim në votim pikën nr. 5.

**U votua**

**Pro** 20

**Kundër** 0

**Abstenim** 0

**Miratohet** (**Po**) **Jo**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA POGRADEC

Miratohet pika nr. 5. e rendit të ditës me 20 vota pro

**Mbledhje e Këshillit Bashkiak** **Pogradec më 23.01.2022**

6. **Pika nr 6** : Për miratimin e kalendarit të programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe të buxhetit vjetor 2022 bashkia pogradec

Diskutime

z. S. Manperi:
Vazhdojmë me pikën nr. 6 për miratimin e kalendarit të programit buxhetor afatmesëm 2023 - 2025 dhe të buxhetit vjetor 2022 Bashkia Pogradec.
Për arsye shëndetësore përfaqësuesit e drejtorisë së financës nuk janë paraqitur.
Kalendari i programit buxhetor afatmesëm është një renditje kronologjike dhe po miratohet çdo fillimviti
z. Sh. Leka: Sipas ligjit përkatës është bërë kalendari i programit buxhetor, i cili miratohet çdo fillim viti, ndaj të shohim me pozitivitet.
S. Manperi:
Ftoj këshilltarët të hedhim në votim pikën nr. 6 të rendit të ditës.

**U votua**

**Pro** 20

**Kundër** 0

**Abstenim** 0

**Miratohet** (**Po**) **Jo**

Miratohet pika nr. 6 e rendit të ditës me 20 vota pro.

**Mbledhje e Këshillit Bashkiak** **Pogradec më 20.01.2022**

7. **Pika nr 7** : Për lënien në fuqi të Vendimit Nr. 94, datë 18.11.2021 "Për një Ndryshim në Vendimin Nr. 15, datë 01.03.2017, "Për miratimin e orareve dhe stacioneve për linjat rrethqytetëse".

Diskutime

z. S. Mangerei. Pika nr. 7 është për lënien në fuqi të Vendimit Nr. 94, datë 18.11.2021 "Për një ndryshim në vendimin nr. 15, datë 01.03.2017, për miratimin e orareve dhe stacioneve për linjat rrethqytetëse".
Nga Pogradeci për në Lin nisen rreth 13 furgona. Shtuam edhe një orar tjetër si të fundit nga ora 16:00 në orën 18:00 të jetë nisja e fundit.
z. S. Haxhillari: Kjo ka ndodhur për shkak të Këshillit të këtij vendimi nga prefektura.
Linja Lin – Pogradec është një pafundësi oraresh. Megjithatë, oraret janë të zëna. Problemi është nëse zbatohen apo jo këto orare, ndaj të miratojmë.
z. S. Mangerei:
I kërkoj Nexhatit informacion për linjën Tushemisht – Pogradec.
z. M. Shuli: Do doja që të kishim edhe një informacion edhe për linjën Pogradec – Sovjan.
z. R. Jakiçar: Unë mendoj që orari i linjës Pogradec – Lin të dalë me (dy) vendime të ndryshme.
Gjatë sezonit të jetë orari më i zgjatur, dhe gjatë periudhës tjetër të jetë një orar më i shkurtuar.

z. S. Mangerei: Ftoj këshilltarët të hedhim në votim pikën nr. 7 të rendit të ditës.

**U votua**

**Pro** 19

**Kundër** 0

**Abstenim** 1 (R. Jaugar) **Miratohet** **Po** **Jo**

Miratohet pika nr. 7 e rendit të ditës me 19 vota pro.

8. **Pika nr** 8 **: Per** dhënie ndihmë financiare znj.Zhuljeta Pere me qëllim mbulimin e shpenzimeve të shkollimit të vajzës".

Diskutime

Z. S. Mangori: Kjo pikë ka të bëjë me dhënien e ndihmës financiare për vajzën e znj.Zhuljeta Pere, Anxhela Mexhori.
Vajza është tetraplegjike, por është studente shumë e mirë.

Mendoj që ndihma financiare për Anxhelën të shihet më tepër si inkurajim nga ana jonë për rezultatet e arritura.

Z. B. Makrori; Jam i kënaqur që kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak kanë qenë gjithmonë të kujdesshëm në të tilla, ndaj mendoj të votojmë duke e përgëzuar vajzën për arriturat.

Z. S. Mangori: Ftoj Këshilltarët të hedhim në votim

**U votua**

**Pro** 19

**Kundër** 0

**Abstenim** 1 (K. Pasko)

**Miratohet** **Po** **Jo**

Miratohet pika nr. 8 e rendit të ditës me 19 vota pro

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA POGRADEC

z. S. Manferei

Në adresën e Këshillit Bashkiak kanë mbërritur disa kërkesa.

1 Gjani Sorei nga fshati Lakatesh kërkon ndihmë sepse i është prishur shtëpia nga erozioni.

Materiali ti përcillet drejtorisë në emergjencave civile.

2. Kërkesa e dytë vjen nga banorët e fshatit Selcë e Poshtme, e njësisë administrative Proptisht.

Banorët të cilët kanë bërë kërkesën kërkojnë që t'iu rregullohet një rrugë rreth 500m që lidh rrugën kryesore me shtëpitë e tyre.

Kërkesa mendoj ti përcillet kryetarit të Bashkisë.

Përveç këtyre dy kërkesave, në sallën e Këshillit Bashkiak kemi edhe një pyetësore që ka një problem.

Pyetësorja -> Përshëndetje!

Kam problemin e privatizimit të shtëpisë e cila ndodhet në zonën e ish parkut.

Të gjitha dokumentat i kam çuar tek zyra e Strehimit, por juristi i Bashkisë më thot që problemi i privatizimit të banesës sime zgjidhet vetëm me gjyqi.

z. Manferei: Po, ju duhet të pajtoni një avokat, i cili t'ju orientojë për procedurat e mëtejshme që do ju duhet të ndiqni.

z. S. Hoxhillari: Ju duhet të shfrytëzoni mundësin që ju afron Kodi Civil për të privatizuar banesën tuaj, por kjo nuk bëhet nëse nuk pajtoni një avokat për t'ju udhëzuar.

z. S. Manferei: Mbledhjen e datës 20.01.2022 e deklaroj të mbyllur!

Protokolloi: Nadalda Tollaku ~~[illegible]~~ Miratoi: Sekr. Këshillit Tana Rolli